2. Ky vendim nuk do të zbatohet në rastin e kërkesave për shpronësim, të cilat janë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.874, datë 12.12.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS CUKALAT TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Cukalat të qarkut të Beratit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 613 (gjashtëqind e trembëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Cukalatit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**URDHËR**
**Nr.209, datë 19.12.2007**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR REALIZIMIN E STUDIMIT TË THELLUAR TË PAKETËS FISKALE TË PUSHTETIT VENDOR**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, për realizimin e studimit të thelluar të paketës fiskale të pushtetit vendor.

2. Grupi i punës të kryesohet nga këshilltari i Kryeministrit për çështjet e financave publike, z.Petraq Milo dhe, në përbërje të ketë:

- z.Skënder Uku specialist në Ministrinë e Financave;
- znj. Arjana Dyrmishi specialiste në Ministrinë e Financave.

Në mbledhjet e grupit të punës, në cilësinë e ekspertit, të përfshihen sipas propozimeve të ardhura nga shoqata e kryetarëve të bashkive edhe këta përfaqësues:

- znj.Albana Dhimitri nënkryetare e bashkisë Tiranë;
- z.Juli Cani specialist, nga shoqata e kryetarëve të bashkive;
- znj.Belinda Ikonomi specialiste, bashkia Tiranë.

3. Grupi i punës të shqyrtojë praktikat e ndjekura deri tani, në kuadër të autonomisë financiare të pushtetit vendor, për decentralizimin e taksave vendore, si dhe të studiojë mundësitë e mëtejshme të këtij decentralizimi fiskal, në bazë të përvojës së vendeve të Europës Juglindore dhe Qendrore, që janë integruar apo synojnë të integrohen në Bashkimin Europian.

4. Studimi i plotë i paketës fiskale t'i paraqitet Kryeministrit dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë brenda 2 muajve nga data e ngritjes së grupit ndërinstitucional të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.79, datë 21.12.2007**

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "GSA" SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3, nenit 13 pika 1 germa "dh", si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenet 14, 16 të "Rregullores së procedurave te licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "GSA" sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë "GSA" sh.p.k., në aktivitetin e importit të energjisë elektrike, për periudhën nga 27.1.2008 deri më 26.1.2011.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe

Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë me shkrim aplikuesin (Shoqërinë “GSA” sh.p.k.).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

## VENDIM
## Nr.80, datë 21.12.2007

### PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK NË KARABURUN, MALET KANALIT E LLOGARA), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” nenit 10, pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 21.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik në Karaburun, Malet Kanalit e Llogara), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik në Karaburun, Malet Kanalit e Llogara), si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

## VENDIM
## Nr.81, datë 24.12.2007

### PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR VITIN 2008

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në vendimin nr.5, datë 26.1.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë

elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të ERE–s në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike, nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2008,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi deri në datën 29 shkurt 2008 të vendimit nr.6, datë 26.1.2007 për çmimin unik të shitjes së energjisë elektrike nga të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike, nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

## VENDIM
## Nr.82, datë 24.12.2007

## PËR PËRCAKTIMIN PËR VITIN 2008 TË ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW TË DHËNA ME KONCESION

Në mbështetje të nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu IV, pika 1 “a” dhe vendimit nr.24, datë 11. 4.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar, deri në 10 MW të dhëna me koncesion”, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW të dhëna me koncesion, për vitin 2008,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW të dhëna me koncesion, për periudhën 1.1.2008 deri me 31.12.2008, është 9.37 lekë/kWh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**
**Nr.83, datë 24.12.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË KESH SHA PËR DISA NDRYSHIME NË "RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të nenit 2 të ligjit nr.9626, datë 16.10.2006 "Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike"", të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18 dhe të "Rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike", neni 12, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.100, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike",

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së KESH sh.a. për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike",

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**
**Nr.85, datë 26.12.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË SISTEMIT TË NJËJTË TË LLOGARIVE PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 21 dhe 23 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 26.12.2007, pasi shqyrtoi draftin e sistemit të njëjtë të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të sistemit të njëjtë të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**

**KËRKESË**
**Nr.8095/2, datë 27.11.2007**

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte, pjesa e dytë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen-Kalimash".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Proces regjistrimi dhe proces verifikimi", do të kryhen verifikime në përfundim të procesit të regjistrimit, nëse përputhen titujt e pronësisë, si dhe nëse përputhen sipërfaqet me të dhënat në dokumentacionin e pronësisë (certifikatë, kartelë pasurie dhe hartë treguese), pra ju bëjmë me dije se në përfundim të procesit të regjistrimit mund të ketë ndryshime në emra dhe vlerë sipas të dhënave ligjore, që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë.

Për pronarët që është bërë shënimi "Ripublikim", ka ndryshuar vlera e shpronësimit për objekte, si rezultat i riverifikimeve të kryera nga grupi i punës në terren.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 2.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 122 235 961 (njëqind e njëzet e dy milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

**LISTA E PRONAREVE TE OBJEKTEVE GJATE SEGMENTIT RRUGOR**
**RRESHEN KALIMASH (PJESA E DYTË)**

| NR. | PRONARI | VLERA LEKE | SHENIME |
|---|---|---|---|
| 1 | Simon Kol Kolaj | 5900946 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 2 | Gjet Llesh Prenga | 2209718 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Gjon Llesh Ndreca | 8472844 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 3 | Marie Frrok Skana | 6103768 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 4 | Ded Llesh Ndreca | 7424730 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Nikoll Llesh Ndreca | | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Gjok Llesh Ndreca | | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 5 | Zek Gjon Markpepa | 2753953 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 6 | Ded Kol Skana | 1927083 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| 7 | Pjetër Nikoll Lleshi | 1810048 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | (Dedin) Gjon Preng Marku | 3638330 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **8** | Martë Preng Vorfi | 723429 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **9** | Bardhok Pjetër Pjetri | 2423745 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **10** | Gjin Nikoll Nikolli | 2646818 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **11** | (Mirash) Ndue Zef Përshqefa | 1076950 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **12** | Mëhill Zef Prenga (Ahengu) | 915779 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **13** | Preng Gjetë Prenga (Marku) | 2384960 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **14** | Nikoll Llesh Prenga | 6481512 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **15** | Mark Ndue Nikolli | 3150698 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Bib Ndue Nikolli | 1538246 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **16** | (Gjin) Pashk Zef Tuci | 985273 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Pjetër Ndue Tuci | 1090520 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Zef Pjetër Tuci | 1046564 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **17** | Gjetë Mark Tuci | 2469192 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **18** | Frrok Zef Lleshi | 2167304 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Mark Zef Lleshi | 547603 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **19** | Nik Zef Gjoka | 5331540 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **20** | Pjetër Zef Poci | 934582 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Ndue Nikoll Marku | 1981886 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Leon Ndue Prenga | 1484412 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **21** | Ndoc Ded Deda | 2255898 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **22** | Ndue Gjon Ndreca | 1793502 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **23** | Nikoll Zef Gjaci | 5104705 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| | Albert Zef Gjaci | 1794047 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **24** | Gjon Mark Lleshi | 1182385 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **25** | Ndue Gjon Lleshi | 1653820 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **26** | Mark Ndue Lleshi | 2420494 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **27** | Viktor Preng Lleshi | 142360 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **28** | Nikolin Gjon Nikolli | 3548455 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **29** | Nikoll Vokërr Nikolli | **1941987** | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **30** | Gjet Vokërr Nikolli | 2204452 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **31** | Preng Pjetër Prenga | 4787209 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **32** | Gjetë Kol Marleka | 998995 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **33** | Llesh Gegë Pjetri | 493067 | Proces regjistrimi dhe Proces verifikimi |
| **34** | **Nikoll Llesh Pjetri** | 1968786 | Ripublikim |
| **35** | **Viktor Fran Pjetri** | 4554859 | Ripublikim |
| **36** | **Tonin, Nikoll, Gjetë Dod Nikolli** | 5768507 | Ripublikim |
| | | | |
| | **TOTALI** | **122235961** | |

**KËRKESË**
**Nr.9067/1, datë 11.12.2007**

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen-Kalimash" (pjesa e dytë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Proces regjistrimi", do të kryhen verifikime në përfundim të procesit të regjistrimit, nëse përputhen titujt e pronësisë, si dhe nëse përputhen sipërfaqet me të dhënat në dokumentacionin e pronësisë (certifikatë, kartelë pasurie dhe hartë treguese), pra ju bëjmë me dije se në përfundim të procesit të regjistrimit mund të ketë ndryshime në emra dhe vlerë sipas të dhënave ligjore, që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, kjo për arsye se zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Mirditë, (Rrëshen), është duke bërë regjistrimin e pasurive në fjalë. Në përfundim të këtij procesi do të procedohet në bazë të të dhënave zyrtare që do të konfirmohen nga kjo zyrë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 111 516 455 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

# LISTA E SHPRONESIMEVE PER SEKSIONIN "REPS-THIRRE"

| Nr. | PROGRESIVE | (EMRI,ATESIA,MBIEMRI) | NR.ZK | NR.PASU | SIP. ARE(m2) | CMIMI | VLERA | SHENIME | FSHATI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prog 0+000 - 0+101.5 | I PAIDENTIFIKUAR | | 1000 | 4513.0 | 500 | 2256500 | Proces regjistrimi | RRESHEN |
| 2 | Prog 0+107.4 - 0+309.9 | I PAIDENTIFIKUAR | | 1001 | 2320.0 | 500 | 1160000 | Proces regjistrimi | RRESHEN |
| 3 | Prog 0+315.6 - 0+366.5 | I PAIDENTIFIKUAR | | 103 | 9126.0 | 500 | 4563000 | Proces regjistrimi | RRESHEN |
| 4 | Prog.0+485.02 - 0+737.85 | NIKOLL MARK GJOKA | 2769 | 267 | 11522.89 | 500 | 5761445 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 5 | Prog.0+967.02 - 1+092.27 | ALEKSANDER KOL PERLEKA | 2769 | 255/3 | 5081.44 | 500 | 2540720 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 6 | Prog.0+855.64 - 1+023.25 | ALEKSANDER KOL PERLEKA | 2769 | 261/2 | 6352.87 | 500 | 3176435 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 7 | Prog.0+913.55 - 1+069.92 | GJOVALIN KOL PERLEKA | 2769 | 261/3 | 2127.78 | 500 | 1063890 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 8 | Prog.1+733.30 - 1+935.21 | PASHK PRENG PERLOSHI | 2769 | 77 ; 78 | 10470.54 | 500 | 5235270 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 9 | Prog.2+035.57 - 2+292.41 | ALEKSANDER ZEF BRUNGA | 2769 | 73/4 | 13243.61 | 500 | 6621805 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 10 | Prog.2+435.53 - 2+485.38 | MARK PERLEKA | 2769 | 71/3 | 1453.93 | 500 | 726965 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 11 | Prog.2+473.77 - 2+564.47 | BARDHOK GJON PERLEKA | 2769 | 19/5 | 3147.81 | 500 | 1573905 | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 12 | | PRENG PJETER PERLEKA | 2769 | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 13 | | DAVA LLESH PERLEKA | 2769 | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFUSHAZ |
| 14 | Prog.5+676.78 - 5+749.65 | GJOK PJETER NIKOLLI | 2768 | 303/3 | 4062 | 500 | 2031000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 15 | Prog.5+726.22 - 5+780.90 | GJOK PJETER NIKOLLI | 2768 | 302/4 | 2144.84 | 500 | 1072420 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 16 | | NIKOLL KOL NIKOLLI | 2768 | 302/5 | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 17 | | DRITAN PJETER NIKOLLI | 2768 | 302/6 | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 18 | | DED NIKOLL NIKOLLI | 2768 | 302/3 | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 19 | Prog.5+750.95 - 5+939.33 | NIKOLL KOL NIKOLLI | 2768 | 303/25 | 8652.81 | 500 | 4326405 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 20 | Prog.5+996.97- 6+237.38 | BARDHOK MARK MARKU | 2768 | 303/21 | 12552.22 | 500 | 6276110 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 21 | Prog.6+391.10 - 6+430.64 | FRAN LAZER BARDHI | 2768 | | 1676.00 | 500 | 838000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | Prog.6+394.33 - 6+679.67 | PJETER NDUE DODA | 2768 | 345/9 | 5575 | 500 | 2787500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 23 | Prog.6+415.23 - 6+510.91 | FRAN FRROK DODA | 2768 | 345/23 | 1180 | 500 | 590000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 24 | Prog 6+510 - 6+679.8 | LIZA FRROK DODA | 2768 | 345/15 | 909.00 | 500 | 454500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 25 | | DAVA FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 26 | | BARDHE FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 27 | | PRENC FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 28 | | DILA FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 29 | | PRENE FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 30 | | FRAN FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 31 | | LEKE FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 32 | | MAJLINDA FRROK DODA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 33 | Prog 6+530 - 6+650 | I PAIDENTIFIKUAR | 2768 | 345/25 | 1073.00 | 500 | 536500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 34 | Prog.6+537 - 6+611 | NDUE NIKOLL PRENGA | 2768 | 345/7 | 1067.00 | 500 | 533500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 35 | Prog 6+537 - 6+663 | NDUE NIKOLL PRENGA | 2768 | 345/8 | 4258.00 | 500 | 2129000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 36 | Prog 6+537 - 6+680 | FRROK NDUE PRENGA | 2768 | 345/10 | 2189.00 | 500 | 1094500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 37 | Prog 6+719.79 - 6+750 | NDUE DODE FEZA | 2768 | 339/4 | 3795.00 | 500 | 1897500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 38 | Prog 6+750 - 6+830 | NIKOLL GJIN CUPI | 2768 | 339/1 | 4202.00 | 500 | 2101000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 39 | Prog 6+750 - 6+830 | PRENG GJOK CUPI | 2768 | 339/2 | 2285.00 | 500 | 1142500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 40 | Prog 6+790 - 6+815 | I PAIDENTIFIKUAR | 2768 | 339/3 | 89.00 | 500 | 44500 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 41 | Prog.8+040.84 - 8+196.59 | DODE GJET DODA | 2768 | 256/4 | 4026 | 500 | 2013000 | Proces regjistrimi | NDERFANE |
| 42 | Prog.8+175.80 - 8+315.02 | NDUE GJON PRENGA | 2768 | 256/5 | 835.39 | 500 | 417695 | Proces regjistrimi | NDREFANE |
| 43 | Prog.8+198.42 - 8+569.72 | IGEL NDUE PRENGA | 2768 | 256/7 | 16274.57 | 500 | 8137285 | Proces regjistrimi | NDREFANE |
| 44 | Prog.8+558.48 - 8+685.07 | XHOVALIN ZEF BARDHI | 2768 | 256/6 | 5286.76 | 500 | 2643380 | Proces regjistrimi | NDREFANE |
| 45 | Prog.8+042.25 - 8+219.44 | DODE GJET DODA | 2768 | 256/8 | 8059.78 | 500 | 4029890 | Proces regjistrimi | NDREFANE |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 46 | Prog.8+727.89 - 8+747.90 | PRONE E PAIDENTIFIKUAR | 2768 | | 474.06 | 500 | 237030 | Proces regjistrimi | NDREFANE |
| 47 | Prog.8+773.29 - 8+821.81 | GJOVALIN NIKOLLI | 2768 | | 1433.68 | 500 | 716840 | Proces regjistrimi | NDREFANE |
| 48 | Prog.11+443 - 11+483 | NDUE GJOK NIKOLLI | 1713 | 148 | 1091.17 | 500 | 545585 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 49 | Prog 11+486.88 - 11+492 | NDUE GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/6 | 1900 | 500 | 950000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 50 | Prog 11+492 - 11+551 | NDUE GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/5 | 2850 | 500 | 1425000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 51 | Prog 11+519 - 11+542 | NDUE GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/8 | 398 | 500 | 199000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 52 | Prog 11+530 - 11+560 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/4 | 2025 | 500 | 1012500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 53 | Prog 11+650 - 11+610 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/3 | 1038 | 500 | 519000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 54 | Prog 11+540 - 11+590 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/7 | 775 | 500 | 387500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 55 | Prog 11+520 - 11+570 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/9 | 405 | 500 | 202500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 56 | Prog 11+540 - 11+560 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/10 | 177 | 500 | 88500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 57 | Prog 11+560 - 11+590 | NIKOLL GJOK NIKOLLI | 1713 | 146/12 | 210 | 500 | 105000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 58 | Prog 11+570 - 11+610 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 146/1 | 2365 | 500 | 1182500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 59 | Prog 11+610 - 11+640 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 146/2 | 1988 | 500 | 994000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 60 | Prog 11+620 - 11+640 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 161/2 | 541.33 | 500 | 270665 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 61 | Prog 11+649 - 11+659 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 145/1 | 211.45 | 500 | 105725 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 62 | Prog 11+660 - 11+680 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 145/2 | 365.45 | 500 | 182725 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 63 | Prog 11+650 - 11+665 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 145/3 | 308 | 500 | 154000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 64 | Prog 11+590 - 11+740 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 143 | 2697 | 500 | 1348500 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 65 | Prog 11+690 - 11+720 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 144/1 | 832 | 500 | 416000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 66 | Prog 11+720 - 11+750 | PASHK FRROK NIKOLLI | 1713 | 144/2 | 372 | 500 | 186000 | Proces regjistrimi | GEZIQ |
| 67 | Prog. 15+534.00 - 15+597.82 | MARK NDUE PJETRI | 2933 | 150;151 | 305.14 | 500 | 152570 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 68 | Prog.15+536.78 - 15+652.75 | LLESH GJET BARDHI | 2933 | | 3683.89 | 500 | 1841945 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 69 | | FRROK DODE MARKU | | | | 500 | | Proces regjistrimi | PESHQESH |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 70 | | GJOVALIN LLESH MARKU | | | | 500 | | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 71 | Prog.15+657.48 - 15+687.65 | FRAN NDUE BIBA | 2933 | | 1696.87 | 500 | 848435 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 72 | Prog.15+657.48 - 15+730.45 | PASHKE NDUE MARKU | 2933 | | 1837.49 | 500 | 918745 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 73 | | LLESH GJON MARKU | | | | 500 | | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 74 | Prog.15+720.11 - 15+778.67 | FRAN NIKOLL SHTJEFNI | 2933 | | 1725.89 | 500 | 862945 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 75 | Prog.15+709.61 - 15+812.94 | PASHKE NDUE MARKU | 2933 | | 1838.41 | 500 | 919205 | Proces regjistrimi | PESHQESH |
| 76 | Prog. 16+137.90 - 16+176.82 | NIKOLL MARK GEGA | 1221 | 176 | 484.9 | 500 | 242450 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 77 | Prog. 16+521.83 - 16+704.33 | I PAIDENTIFIKUAR | 1221 | | 685.85 | 500 | 342925 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 78 | Prog.16+759.31 - 16+800.81 | PJETER MARK GEGA | 1221 | 253 ; 253/2 | 1663.96 | 500 | 831980 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 79 | Prog. 17+812.50 - 17+869.45 | GJIN MARK PRENI | 1221 | 75 | 3105.27 | 500 | 1552635 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 80 | Prog. 17+951.73 - 18+048.18 | DED PRENG PRENDI | 1221 | 78 | 3900 | 500 | 1950000 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 81 | Prog 18+035 - 18+075 | FRAN NIKOLL PRENDI | | 81/1 | 785 | 500 | 392500 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 82 | Prog. 18+033.68 - 18+094.62 | BARDHOK GJERGJ PRENDI | 1221 | 81/2 | 904.00 | 500 | 452000 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 83 | Prog.0+366.49 - 0+447.47 | GJET FRROK TUSHA | 1221 | 81/3 | 1483.89 | 500 | 741945 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 84 | | TONIN FRROK TUSHA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | |
| 85 | Prog.18+117.49 - 18+184.49 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | 83 | 500.17 | 500 | 250085 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 86 | Prog 18+049 - 18+068 | I PAIDENTIFIKUAR | 1221 | 81/4 | 178 | 500 | 89000 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 87 | Prog.18+047.02 - 18+077.36 | BARDHOK GJERGJ PRENDI | 1221 | | 324.25 | 500 | 162125 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 88 | Prog.18+066.72 - 18+149.41 | GJIN MARK PRENI | 1221 | | 1454.55 | 500 | 727275 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 89 | Prog.18+100.00 - 18+149.41 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | | 1329.51 | 500 | 664755 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 90 | Prog. 18+144.59 - 18+190.47 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | | 1131.91 | 500 | 565955 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 91 | Prog.18+149.41 - 18+196.63 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | | 457.29 | 500 | 228645 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 92 | Prog.18+192 - 18+226 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | 88/1 | 1743 | 500 | 871500 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 93 | Prog.18+192 - 18+227 | DED PRENG PRENDI | 1221 | 88/4 | 455 | 500 | 227500 | Proces regjistrimi | BLINISHT |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 94 | Prog.18+192 - 18+227.4 | DED PRENG PRENDI | 1221 | 88/2 | 730 | 500 | 365000 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 95 | Prog.18+195 - 18+231 | FRAN NIKOLL PRENDI | 1221 | 88/3 | 227 | 500 | 113500 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 96 | Prog.18+239 - 18+320 | MHILL KOL GJOKA | 1221 | 86 | 1924 | 500 | 962000 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 97 | Prog.18+409.26 - 18+505.78 | I PAIDENTIFIKUAR | 1221 | | 1064.78 | 500 | 532390 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 98 | Prog.18+616.76 - 18+751.52 | GJERGJ NDUE PRENGA | 1221 | 90/1 ; 59/12 | 4085.90 | 500 | 2042950 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 99 | | NDUE PJETER PRENGA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 100 | Prog.18+670.35 - 18+787.26 | NDUE PJETER PRENGA | 1221 | 90/2 ; 90/6 | 891.98 | 500 | 445990 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 101 | | MEHILL KOL GJOKA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 102 | | NDUE MEHILL GJOKA | | | | 500 | | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| 103 | Prog. 18+769.00 - 18+804.90 | MARK NDUE MARFANA | 1221 | 59/14 | 425.63 | 500 | 212815 | Proces regjistrimi | BLINISHT |
| | **TOTALI** | | | | | | **111516455** | | |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

***Së shpejti në treg:***

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 27.12.2007
Doli nga shtypi më 28.12.2007

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 40 lekë